



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VORË  
KRYETARI

Nr. 8005 prot.

Vorë, më 19. 11.2021

**NJOFTIM PUBLIK**

Bazuar ne ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqevirisjen Vendore”, neni 9, gërma b, ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, VKM nr. 816, datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe mardhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike”;

Pranë Bashkisë Vorë është ngritur dhe funksionon **Struktura Përgjegjëse për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve.**

Për sa më sipër:

- Çdo person, i cili vihet në dijeni për veprime ose praktika të dyshuara të korrupsionit, gjatë punës ose në lidhje me veprimtarinë e tij të punës pranë organizatës, ka të drejtë të sinjalizojë këtë fakt te njësia përgjegjëse brenda organizatës ose ILDKPKI-së, sipas rastit.
- Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para ILDKPKI-së ose njësisë përgjegjëse dhe dokumentohet me shkrim prej tyre. Sinjalizimi përmban të paktën:
  - a) të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;
  - b) të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
  - c) përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;
  - ç) referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit;
  - d) në rastin e sinjalizimit të jashtëm, shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm.

2. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet, nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit

3. Pavarësisht nga ekzistenca e njësisë përgjegjëse pranë organizatës, sinjalizuesi mund të nisë një procedurë të jashtme sinjalizimi pranë ILDKPKI-së, sipas nenit 11 të këtij ligj

- 1. Sinjalizuesit i ofrohet mbrojtja për sinjalizimin e kryer në kushtet e mirëbesimit, të një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni, sipas kritereve të parashikuara në këtë ligj.

Të drejtat dhe interesat e sinjalizuesve mbrohen në mënyrë të besueshme, të efektshme dhe të përshtatshme.

2. Sinjalizuesi gëzon të drejtën e:

a) konfidencialitetit gjatë procesit të sinjalizimit, që përfshin, gjithashtu, mundësinë e sinjalizimit anonim të një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni, sipas nenit 7, pika 2, të këtij ligji;

b) ruajtjen e konfidencialitetit të burimit të informacionit të sinjalizuesit;

c) mbrojtjes kundër hakmarrjes.

- Në rast se sinjalizuesi njofton publikisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, gëzon të drejtën e mbrojtjes, sipas këtij ligji, deri në çastin kur sinjalizimi bëhet publik.

**KRYETAR**

**GENTIAN PICARI**

